VENDIM
Nr. 419, datë 27.6.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8449, date 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Emërtesa në shkronjën "b" të pikës 5.6 të nenit 5 të kreut I, titulli II, pjesa I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Sektori i metodologjisë së vlerësimit doganor.".

2. Në nenin 18 të kreut 6, titulli II, pjesa I, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën 18.1.5, fjalët "... neni 606 ..." zëvendësohen me "... neni 609 ...".

- Në shkronjën "c" të pikës 18.2, fjalët "... pas rishqyrtimit, kur arsyet për këtë vendim mbështeten nga një raport me shkrim, ..." hiqen.

- Pas pikës 18.2 shtohet pika 18.2.2 me këtë përmbajtje:

"18.2.2 Në rastet kur gjykohet dhënia e masës administrative "Largim nga puna", titullari i institucionit, pasi është shprehur në lidhje me rekomandimin e komitetit disiplinor, sipas pikës 18.2 të këtij vendimi, vetë ose përmes delegimit, zbaton procedurën, njoftimet dhe afatet e përcaktuara në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në veçanti, ai duhet:

a) të njoftojë me shkrim, në adresën e shtëpisë dhe adresën e punës, punonjësin doganor të paktën 72 (shtatëdhjetë e dy) orë para takimit dhe të bisedojë me të duke i parashtruar arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe duke i dhënë atij mundësi për t'u shprehur;

b) të njoftojë me shkrim punonjësin doganor në të dyja adresat e sipërpërmendura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, brenda një afati nga 48 (dyzet e tetë) orë deri në një javë pas takimit.

Kjo procedurë zbatohet edhe në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës.".

- Pas pikës 18.5.1 shtohet pika 18.6., me këtë përmbajtje:

"18.6. Në të gjitha rastet e përfundimit të marrëdhënieve të punës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të zbatojë procedurën dhe afatet e njoftimit të paracaktuara në kreun XIV të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.".

3. Pika 7 e nenit 113 shfuqizohet.

4. Në kreun 2, titulli III, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- Pas shkronjës "dh" të pikës 1 të nenit 247, shtohet shkronja "e", me përmbajtje:

"e) Përjashtimisht nga përcaktimi i shkronjës "d" të kësaj pike, për mallrat që hyjnë në magazinat e tipit C – *duty free shops* dhe *duty free*, në bordin e avionëve, nuk kërkohet garancia e parashikuar në shkronjën "d".".

- Pikat 5 dhe 10.4 të nenit 248, shfuqizohen.

5. Në titullin V, kreu I, seksioni 2, pas nenit 457 shtohet neni 457/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 457/1

1. Magazinat e lira të karburanteve në portet e përcaktuara për administrimin e lëndëve djegëse do të marrin në ngarkim produktet e marra në sasitë e matura në tokë nën mbikëqyrjen e doganës.

2. Me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes në magazinat e lira do të hyjnë: karburante, lëndë djegëse, lëndë të para për prodhimin e biodiezelit dhe karburante bio.

3. Pagesat e kryera nga operatorët ekonomikë, për efekt të zbatimit të pikës 7 të nenit 113 dhe pikave 5 dhe 10.4 të nenit 248, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk rimbursohen nga autoriteti doganor.

4. Garancitë e depozituara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nga magazinat e tipit C – *duty free*

shops, për efekt të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 247, çlirohen menjëherë nga autoritetet doganore, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha